

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"5 Maji" zonë e re për zhvillim, cilat janë njësitë zbatuese të përcaktuara me VKM për rindërtim
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/5-maji-zone-e-re-per-zhvillim-cilat-jane-njesite-zbatuese-te-percaktu-i401454
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:45:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1354e2c4f0829e58066477e1338f28690f6d9b76e17e5727e02fcf1fd6b3b5a5
TEKSTI	027dc212ebc97c2d532561144acf01d1c5f04a1da841d9fd1a19717f482d95b0
PAMJA	43d66dc7364ca60de79fab7190da55c579199f0c9131bad839549c5e5e93eab2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	172c3327da657265907af450c3da34ea57aa98152d94b868a1c5c989a6334540
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/172c3327da657265907af450c3da34ea57aa98152d94b868a1c5c989a6334540>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

17 Shtator 2026, 14:40

"5 Maji" zonë e re për zhvillim, cilat janë njësitë zbatuese të përcaktuara me VKM për rindërtim



Shkruar nga Newsbomb



Foto akrive nga "5 Maji"

Këshilli i Ministrave ka miratuar së fundi shpalljen e zonës së re për zhvillimin në njësitë administrative 4 dhe 8, të cilat përfshijnë zonën e "5 Majit" në Bashkinë e Tiranës. Sipas këtij vendimi në klistën e njësisë zbatuese për procesin e rindërtimit përfshihen Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH), Bashkia Tiranë dhe shoqëria "Tirana DC" sh.a.

Përmes këtij ndryshimi përcaktohet se, bashkia Tiranë dhe "Tirana DC" sh.a, do të vijnë zbatimin e projekteve të nisura dhe në vijim në kuadër të procesit të rindërtimit.

Ndërsa sa i përket Fondit Shqiptar të Zhvillimit, ai është caktuar si njësi zbatuese për projektet e reja të rindërtimit në këtë zonë, përfshirë ndërtimin e banesave të reja apo ndërtesave publike të dëmtuara, si edhe ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike e kritike. Më tej parashikohen të përfshihen realizimi i ndërtimeve, dhe ndërhyrje të tjera në funksion të rindërtimit.

Për zbatimin e vendimit janë ngarkuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkia Tiranë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Vendimi ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në fletoren zyrtare.

Vendimi i Këshillit të Ministrave:

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Showbiz & Lifestyle

Mediat serbe "sulmojnë" Granit Xhakën, Dua Lipën dhe Rita Ora: Qëndruan pranë "krimineleve" të UÇK-së



Politikë

"Mbllidh mendjen e hiq dorë nga detyra, pl një kafe me Karçanaj!" Berisha LËVDATE Evis Salës e kritika Spahit, ministria: Keni qenë profesor im...

Zbulu më shumë artikuj >

DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR.78, DATË 31.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 DHE 8, ZONA "5 MAJI", BASHKIA TIRANË, DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË DHE SHOQËRISË "TIRANA DC", SH.A., SI NJËSI ZBATUESE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "iii" e "iv", dhe 16, pika 3, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Në vendimin nr.78, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe bëhet, si më poshtë vijon:

"Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësitë administrative 4 e 8, zona "5 Maji", Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë, shoqërisë "Tirana DC", sh.a., dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese".

2. Në pikën 2, fjalia hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese për zbatimin e projekteve të nisura e në vijim, në kuadër të procesit të rindërtimit, për: ...".

3. Në pikën 2.1, fjalia hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Caktimin e "Tirana DC", sh.a., si njësi zbatuese për zbatimin e projekteve të nisura e në vijim, në kuadër të procesit të rindërtimit, për: ...".

4. Pas pikës 2.1 shtohet pika 2.2, me këtë përmbajtje:

"2.2 Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për zbatimin e projekteve të reja, në kuadër të procesit të rindërtimit, për:

a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;

b) ndërtimin e rikonstruksionin e infrastrukturës publike dhe kritike;

c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;

ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

II. Aneksat bashkëlidhur vendimit nr.78, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohen me aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





E Enjte 14:09

Dha alarm se në shkollën në Tiranë kishte bombë, protestuesi e thotë para gjykatësit: Do e bëj sërish; Gjykata vendos ta lërë të lirë



Aktualitet

Vendimi i Hagës për katër ish-krerët e UÇK-së, veteranët dalin në protestë: Nesër tubim gjithëpopullor në Prishtinë

E Enjte 14:14



Aktualitet

Për pesë vite mori 16 leje, herën e fundit "u zhdruk", dyshohet se Alket Rizai ka kaluar kufirin dhe fshihet në Shqipëri (DETAJET e fundit)

E Enjte 13:55 Newsbomb



E Enjte 13:39

Tensione dhe përplasje në protestë, 11 persona shoqërohen në komisariat



Aktualitet

RTSH ndryshon identitetin vizual dhe programacionin, pesë produksione ndërkombëtare në sezonin e ri

E Enjte 13:32



Aktualitet


Vodhën me dhunë xhiron në dy pika karburanti në Bulqizë, policia identifikon njërin prej autorëve

E Enjte 13:23



🕒 E Enjte 13:08

Lihen të lirë të gjithë protestuesit e arrestuar, nxirret nga qelia edhe 47-vjeçari që alarmoi Policinë se te shkolla "Emin Duraku" kishte bombë



Aktualitet

ZBARDHET skema! Si u tjetërsuan tokat në Seman, biznesmeni bashkëpunoi me ish-zyrtarët e Kadastrës, momenti i shoqërimit me "Bentley" (VIDEO)

Aktualitet

Haga i vulosi 25 vite burg, bashkëshortja e Jakup Krasniqit nxjerr mesazhin që ai i dërgoi pas vendimit

🕒 E Enjte 12:55

🕒 E Enjte 12:38



🕒 E Enjte 12:25

Protestuesit tentojnë të çajnë kordonin e policisë, shoqërohet Dritan Goxhaj, bashkë me të dhe dy qytetarë të tjerë (PAMJE NGA TENSIONET PARA KUVENDIT)





Aktualitet

Përplasje mes policit dhe qytetarit te ministria e Brendshme, protestuesit "s'i mbajnë nervat": Hiqe uniformën po ta mbajti b*tha, ta tregon babi im qejfin ty

🕒 E Enjte 11:32



Aktualitet

Ndalimi i telefonave në seanca gjyqësore, GJKKO i përgjigjet Dhomës së Avokatisë: Ndalimi i tyre është një mase për ruajtjen e rendit dhe sigurisë

🕒 E Enjte 11:25



Aktualitet

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.